



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.4.2023

Nr: 355

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E REZULTATIT TË SHORTIT PËR PËRCAKTIMIN E RENDITJES SË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 98, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e rezultatit të shortit, duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë çdo subjekt zgjedhor në fletën e votimit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

SHORTI PËR NUMRIN RENDOR TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE NË FLETËN E VOTIMIT

| |
|---|
| 1. Koalicioni “Bashkë Fitojmë” |
| 2. “Partia Socialiste e Shqipërisë” |
| 3. “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë” |
| 4. “Partia Republikane Shqiptare” |
| 5. “Partia Levizja e Legalitetit” |
| 6. “Partia Demokracia Sociale” |
| 7. Koalicioni “Aleanca Liberale e Djathtë” |
| 8. “Partia Socialdemokrate” |
| 9. “Partia Demokratike” |
| 10. Partia “Aleanca Progresiste L.ZH.K” |
| 11. Partia “Fryma e Re Demokratike” |
| 12. “Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet” |
| 13. “Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë” |
| 14. “Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë” |
| 15. Partia “Bindja Demokratike” |
| 16. Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve |
| 17. Partia “Aleanca Arbnore Kombëtare” |
| 18. “Partia Balli Kombëtar” |
| 19. Partia “Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet” |
| 20. Partia “Lëvizja Punëtore Shqiptare” |
| 21. Partia “Fronti i Majtë” |
| 22. “Partia Unitetit Kombëtar” |
| 23. “Partia e Gjellbër” |
| 24. “Partia Konservatore” |
| 25. Partia “Lëvizja e RE” |
| 26. Partia “Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane” |
| 27. “Partia Kombëtare Konservatore Albania” |
| 28. “Partia Mbrojtjen e të Drejtave të Puntorve të Shqipërisë” |
| 29. Partia “Aleanca Maqedonasve për Integrimin Europian” |
| 30. “Partia Emigracionit Shqiptar” |

| |
|--|
| 31. “Partia e Reformave Demokratike Shqiptare” |
| 32. “Partia Komuniste e Shqipërisë” |
| 33. “Partia Ora e Shqipërisë” |
| 34. “Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë” |
| 35. Partia “Nisma Thurje” |
| 36. Partia “Lëvizja Bashkë” |
| 37. Partia “Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen” |
| 38. “Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë” |
| 39. Partia “Lidhja Demokristiane Shqiptare” |
| 40. Partia “Ardhmërija Shqiptare” |